

RREGULLORE
PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR KRYERJEN E
MONITORIMIT, RAPORTIMIT DHE DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM PËR
T’U PARAQITUR NGA STARTUP-ET DHE LEHTËSUESIT E STARTUP-EVE QË
APLIKOJNË PËR MASA MBËSHTETËSE

PËRMBAJTJA

I. HYRJE	1
II. KATEGORITË PËRFITUESE TË GRANTIT	2
III. NIVELI I FINANCIMIT	3
IV. STARTUP-ET	3
A. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR STARTUP-ET	4
B. AKTIVITETET DHE KOSTOT E LEJUARA PËR STARTUP-ET	4
C. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR STARTUP-ET	5
V. LEHTËSUESIT	5
A. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR LEHTËSUESIT	6
B. AKTIVITETET DHE KOSTOT E LEJUARA PËR LEHTËSUESIT	6
C. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR LEHTËSUESIT	7
VI. KOSTO QË NUK MBULOHEN NGA GRANTI	7
VI. SHPALLJA E THIRRJES PËR APLIKIME	8
VII. PROCEDURA E APLIKIMIT	8
VIII. SHPALLJA E PROJEKTEVE FITUESE	9
IX. PROCEDURA E DISBURSIMIT TË GRANTIT.....	10
X. PROCEDURA E MONITORIMIT TË PROJEKTEVE FITUESE	11
XI. PIKËZIMI	11
XII. PËRGJEGJËSITË E FITUESVE.....	13
XIII. KONFIDENCIALITETI I TË DHËNAVE.....	13
XIV. NJËSIA MENAXHUESE E GRANTIT	13

I. HYRJE

Rregullorja përmban procedurën e aplikimit, dokumentacionin e nevojshëm dhe procedurën e disbursimit dhe monitorimit të projekteve fitues, për mbështetje me grant për *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve.

Granti i vënë në dispozicion ka për qëllim mbështetjen e *startup*-eve dhe lehtësuesve të *startup*-eve të cilët zhvillojnë projekte inovative në fusha prioritare për zhvillimin e vendit, mbështetje për iniciativa që kanë impakt pozitiv mjedisor, fuqizimi i rinisë, fuqizimi i vajzave dhe grave sipërmarrëse, fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social dhe prioritete të tjera, sipas urdhrit të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Granti për mbështetjen e *startup*-eve dhe lehtësuesve të *startup*-eve ka një impakt të rëndësishëm në lehtësimin e krijimit, hyrjes në treg dhe ushtrimit të veprimtarisë së *startup*-eve. Objektivi i kësaj iniciative është të ndihmojë në krijimin e një klime të favorshme për tërheqjen, përfshirjen dhe mbajtjen e talentit dhe burimeve njerëzore, lehtësimin dhe mbështetjen në aksesimin e burimeve financiare dhe përfshirjen sociale dhe diversitetin në mbrojtje të vlerave demokratike, nxitjen dhe futjen e inovacionit në sektorët ekonomikë.

Nga ky grant pritet të përfitojnë *startup*-et që i përkasin tre kategorive kryesore si: *startup*-et në fazën e fillestare, në fazën e rritjes dhe në fazën e zgjerimit dhe gjithashtu lehtësuesit e *startup*-eve të kategorive si akademi e cila përfshin universitetet private dhe publike, bashki, arsim i mesëm dhe profesional, inkubatorë dhe përsheptues, hapësira pune të cilat përfshijnë ofruesit e ambienteve dhe pajisjeve të punës dhe organizues eventesh për *startup*-et.

Përfitimi i *startup*-eve ose lehtësuesve të *startup*-eve nga mbështetja e programeve apo projekteve nga donatorët apo institucione financiare kombëtare dhe ndërkombëtare për mbulimin e shpenzimeve të projektit të cilat janë kontribut i vetë kërkuesit dhe nuk mbulohen nga ky grant, nuk përbën pengesë për përfitimin e grantit, për të njëjtin projekt.

II. KATEGORITË PËRFITUESE TË GRANTIT

Ky grant do të mbështesë 2 kategori aplikuesish siç janë ***startup*-et** dhe **lehtësuesit** e *startup*-eve.

Secila kategori klasifikohet në nën kategori aplikuesish si më poshtë:

Për *startup*-et:

1. *Startup*-et në fazën fillestare;
2. *Startup*-et në fazën e rritjes;
3. *Startup*-et në fazën e zgjerimit.

Për lehtësuesit e *startup*-eve:

1. Akademia, e cila përfshin universitetet publike dhe private;
2. Lehtësuesit si inkubatorët dhe përsheptuesit;
3. Hapësirat e përbashkëta të punës të cilat përfshijnë ofruesit e ambienteve dhe pajisjeve të punës;

4. Bashkitë, përveç Bashkisë së Tiranës;
5. Organizuesit e eventeve;
6. Arsimi parauniversitar, i cili përfshin shkollat e mesme dhe shkollat profesionale publike dhe private.

III. NIVELI I FINANCIMIT

Granti do të mbështesë financiarisht projektet aplikuese që përmbushin kriteret, deri në nivelet maksimale të përcaktuara më poshtë:

Për Startup-et:

1. *Startup*-et në fazën fillestare përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 1, 500, 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
2. *Startup*-et në fazën e rritjes përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 3, 000, 000 (tre milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
3. *Startup*-et në fazën e zgjerimit përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 5, 000, 000 (pesë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.

Për Lehtësuesit:

1. Akademia, e cila përfshin universitetet publike dhe private, përfiton mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 10, 000, 000 (dhjetë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 90% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
2. Lehtësuesit si inkubatorët dhe përsheptuesit, përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 10, 000, 000 (dhjetë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
3. Hapësirat e punës përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 10, 000, 000 (dhjetë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
4. Bashkitë, përveç Bashkisë së Tiranës, përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 20, 000, 000 (njëzet milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 90% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
5. Organizuesit e eventeve, përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 10, 000, 000 (dhjetë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
6. Arsimi parauniversitar, i cili përfshin shkollat e mesme dhe shkollat profesionale publike dhe private, përfiton mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 10, 000, 000 (dhjetë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 90% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.

IV. STARTUP-ET

Do të përfitojnë mbështetje me grant *startup*-t të cilat i përkasin klasifikimit të mëposhtëm:

1. *Startup*-et në fazën fillestare;
2. *Startup*-et në fazën e rritjes;
3. *Startup*-et në fazën e zgjerimit.

A. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR STARTUP-ET

Startup-et që do të mbështeten financiarisht nga ky grant, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë përfunduar vetëdeklarimin në regjistrin elektronik të *startup*-eve dhe të jenë pajisur me pasaportën e *startup*-it; linku i regjistrit të *startup*-eve https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14900
- *Startup*-et në fazën fillestare duhet të kenë përfunduar ose të jenë duke ndjekur një program inkubimi/përsheptimi gjatë periudhës së aplikimit për mbështetje financiare me grant;
- *Startup*-et në fazën e rritjes duhet të jenë të regjistruar në regjistrin tregtar nga 0 – 1 vit;
- *Startup*-et në fazën e zgjerimit duhet të jenë të regjistruar në regjistrin tregtar nga 1 – 5 vite;
- Të jenë Individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, përfshirë nomadin digjital i cili kryen aktivitet në Shqipëri;
- Të kenë përmbushur shlyerjen e detyrimeve tatimore në momentin e aplikimit.
- Një aplikues nuk mund të aplikojë më shumë se një herë për këtë thirrje.

B. AKTIVITETET DHE KOSTOT E LEJUARA PËR STARTUP-ET

Aktivitetet dhe kostot e lejuara në projektet e *startup*-eve, që do të përfitojnë mbështetjen me grant përfshijnë si më poshtë:

1. pjesëmarrje në aktivitete (fee e pjesëmarrjes, biletë vajtje-ardhje avioni dhe akomodim) por jo më shumë se 500,000 lekë në total;
2. pjesëmarrje në konkurse (biletë vajtje-ardhje avioni dhe akomodim) por jo më shumë se 500,000 lekë në total;
3. Pjesëmarrje në panairë ndërkombëtare jo si vizitor (fee e pjesëmarrjes, biletë vajtje-ardhje avioni dhe akomodim); por jo më shumë se 500,000 lekë në total;
4. pjesëmarrje në programe ndërkombëtare inkubimi deri në 3 muaj (fee e pjesëmarrjes, biletë vajtje-ardhje avioni dhe akomodim) por jo më shumë se 500,000 lekë në total;
5. rritje aftësish/kapacitete teknike;
6. blerje makineri dhe/ose pajisje pune;
7. zhvillimi i tregtisë elektronike dhe/ose *software*;

8. patenta dhe liçenca;
9. lëndë e parë dhe ambalazhim/etiketim produkti.

C. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR STARTUP-ET

Startup-et që aplikojnë për mbështetje financiare nga ky grant, duhet të dorëzojnë, gjatë aplikimit, dokumentacionin sipas listës së mëposhtme:

1. Formularin e aplikimit të plotësuar;
2. Formatin e buxhetit të plotësuar;
3. Pasaportën e *startup*-it;
4. Dëshmi e përfundimit ose ndjekjes në proces të një programi inkubimi ose përsheptimi;
5. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT) në rastin e personave fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar;
6. Bilanci i vitit paraardhës për aplikuesin person fizik ose juridik të regjistruar mbi 1 vit në regjistrin tregtar;
7. CV-të e anëtarëve të grupit të punës, përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të aplikimit;
8. Vërtetim për pagim detyrimesh, i marrë nëpërmjet portalit e-albania;
9. Dëshmi penaliteti e aplikuesit, i marrë nëpërmjet portalit e-albania.
10. Çdo dokument tjetër shoqërues që në vlerësimin e aplikuesit mbështet aplikimin tij/saj.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar duhet të jetë në gjuhën shqipe.

V. LEHTËSUESIT

Do të përfitojnë mbështetje me grant lehtësuesit e *startup*-eve të cilët i përkasin klasifikimit të mëposhtëm:

1. Akademia, e cila përfshin universitetet publike dhe private;
2. Lehtësuesit si inkubatorët dhe përsheptuesit;
3. Hapësirat e përbashkëta të punës të cilat përfshijnë ofruesit e ambienteve dhe pajisjeve të punës;
4. Bashkitë, përveç Bashkisë së Tiranës;
5. Organizuesit e eventeve;
6. Arsimi parauniversitar, i cili përfshin shkollat e mesme dhe shkollat profesionale publike dhe private.

A. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR LEHTËSUESIT

Lehtësuesit e *Startup*-eve që do të mbështeten financiarisht nga ky grant, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë përfunduar vetëdeklarimin në regjistrin elektronik të lehtësuesve dhe të jenë pajisur me pasaportën e lehtësuesit; linku i regjistrit të lehtësuesve https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14901
- Të jenë persona fizikë ose juridikë të regjistruar, përfshirë dhe organizatat jo fitimprurëse;
- Të kenë fushë kryesore të veprimtarisë së tyre trajnimit, këshillimit ose dhënien e mbështetjes nëpërmjet formave të ndryshme në fushën e inovacionit dhe/ose të teknologjisë, ose në fusha të ngjashme me to;
- Të kenë përvojë për ofrimin e shërbimeve për mbështetjen e *startup*-eve, të cilat mund të përfshijnë:
 - ofrimin e ambienteve dhe hapësirave të punës, duke mundësuar regjistrimin e selive ligjore dhe ushtrimin e veprimtarive të biznesit në favor të *startup*-eve;
 - ofrimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, si dhe shërbimeve të biznesit, të tilla si zyra, ambiente dhe pajisje pune, kancelari, shërbime interneti me bandë ultra të gjerë, furnizim me energji dhe ujë;
 - administrimin ose drejtimin nga persona me kompetenca dhe përvojë në biznes dhe inovacion;
 - marrëdhënie të rregullta me institucione të arsimit të lartë, qendra kërkimore-shkencore apo partnerë financiarë që kryejnë aktivitete dhe projekte në lidhje me *startup*-et;
 - ofrimin e programeve të inkubimit dhe/ose përsheptimit, duke ofruar mentorim dhe këshillim për realizimin dhe zhvillimin e ideve të biznesit, trajnim nëpërmjet ekspertësh të kualifikuar.
- Aplikuesi duhet të jetë person fizik ose person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, ose në gjykatë në rastin e ofrimit; ose “Lehtësues të *startup*-eve” persona fizikë dhe juridikë që ofrojnë programe dhe shërbime mbështetëse për *startup*-et.
- Të kenë përmbushur shlyerjen e detyrimeve tatimore në momentin e aplikimit.
- Të kenë të përfshirë në projekt aplikim të paktën një element ndërkombëtar (si p.sh: trajner, mentor, aktivitet, program për *startup*-et).
- Një aplikues nuk mund të aplikojë më shumë se një herë për këtë thirrje.

B. AKTIVITETET DHE KOSTOT E LEJUARA PËR LEHTËSUESIT

Aktivitetet dhe kostot e lejuara në projektet e lehtësuesve të *startup*-eve, që do të përfitojnë mbështetjen me grant përfshijnë si më poshtë:

1. infrastrukturë për krijimin e ambienteve dhe programeve të inkubatorëve;

2. rritje kapacitetesh për stafin e universiteteve (por jo më shumë se 500.000 lekë të reja);
3. hapësirë e përbashkët pune në shërbim të studentëve që kanë një ide biznesi;
4. dhomë projektesh me sistem rezervimi online;
5. konkurse kombëtarë për *startup*-et (të përshkallëzuar nga kombëtarë në ndërkombëtarë);
6. evente trajnimi për *startup*-et me shtrirje kombëtare në bashkëpunim me të paktën një partner ndërkombëtar;
7. evente ndërgjegjësimi për *startup*-et me shtrirje kombëtare në bashkëpunim me të paktën një partner ndërkombëtar (por jo më shumë se 500.000 lekë të reja);
8. shërbime mbështetëse, ekspertizë, shkëmbim njohurish për *startup*-et nga ekspertë ndërkombëtarë;
9. evente ndërkombëtare në hapësirën e përbashkët të punës me një audiencë me më shumë se 100 persona;
10. akademi inovacioni për të rinjtë dhe bizneset (njohjen me teknikat e projektimit, gjenerimit të idesë, teknologjitë e reja dhe aplikimin e tyre në biznes).

C. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR LEHTËSUESIT

Lehtësuesit e *startup*-eve që aplikojnë për mbështetje financiare nga ky grant, duhet të dorëzojnë, gjatë aplikimit, dokumentacionin sipas listës së mëposhtme:

1. Formularin e aplikimit të plotësuar;
2. Pasaportën e lehtësuesit;
3. Certifikata e regjistrimit në organin tatimor (NIPT);
4. Ekstrakt i QKB;
5. Akt themelimi dhe statut;
6. CV-të e anëtarëve të grupit të punës, përgjegjës për zbatimin e projektit;
7. Vërtetim nga Drejtoria e Tatim Taksave që aplikuesi në rastin e personave fizikë ose juridikë, nuk ka detyrime të paslyera për sa i përket kontributeve për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatim-taksat.
8. Kopje të ID të aplikuesit.
9. Dëshmi Penaliteti e Drejtuesit Ekzekutiv ose administratorit;
10. Çdo dokument tjetër shoqërues që në vlerësimin e aplikuesit mbështet aplikimin tij/saj.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar duhet të jetë në gjuhën shqipe.

VI. KOSTO QË NUK MBULOHEN NGA GRANTI

Ky grant nuk do të mbulojë kosto të cilat i përkasin kategorisë të mëposhtme:

- Kosto të lindura para datës së nënshkrimit të kontratës së grantit;
- Kosto komerciale, përfshirë përfaqësimin;

- Zbavitje dhe dhurata;
- Kosto të lindura në vazhdimësi prej strukturave dhe detyrimeve ekzistuese;
- Çdo aktivitet i paligjshëm;
- Pjesëmarrja në panaire të armatimit dhe teknologjisë ushtarake;
- Pjesëmarrja në panaire të teknologjisë së duhanit;
- Pjesëmarrje në panaire si vizitor;
- Komisionet bankare;
- Humbjet nga kursi i këmbimit;
- Grant për startup-et e që do të jenë pjesë e projektit fitues të lehtësuesit;
- Tatime Taksa dhe Shpenzime doganore, Tatimi mbi Fitimin, Tatimi mbi Dividendin, Tatimi në Burim, Taksa vendore dhe Kombëtare;
- Shpenzime doganore dhe taksa të tjera.

VI. SHPALLJA E THIRRJES PËR APLIKIME

Thirrja për aplikime do të shpallet në datën 16 maj 2022 dhe do të qendrojë e hapur deri në datën 5 qershor 2022.

Afatet për aplikim janë si në tabelën e mëposhtme:

Hapja e Thirrjes	16 maj 2022
Mbyllja e Thirrjes	5 qershor 2022
Shpallja e fituesve	Brenda datës 20 qershor 2022
Nënshkrimi i marrëveshjes dhe fillimi i zbatimit të projektit	Brenda datës 15 korrik 2022

VII. PROCEDURA E APLIKIMIT

Aplikimi për mbështetje me grant do të kryhet online nëpërmjet faqes dhe adresës elektronike të Ministrisë përgjegjëse për sipërmarrjen.

- Formatet e aplikimit do të shkarkohen në linkun: <https://sipermarrja.gov.al/dokumentet-e-aplikimit/>
- Formatet e aplikimit do të plotësohen nga aplikuesi dhe së bashku me dokumentacionin e kërkuar do të dërgohen me e-mail në adresën: startup@sipermarrja.gov.al.
- Formatet e aplikimit dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të jenë në formatin pdf.
- Dokumentacioni i kërkuar duhet të jetë kopje e skanuar nga origjinali.
- Subjekti i e-mailit duhet të jetë: aplikim *startup*/lehtësues.
- Pas dërgimit me e-mail të aplikimit, aplikuesi do të marrë përgjigje nëpërmjet një e-maili automatik i cili do të konfirmojë marrjen e aplikimit.
- Njësia menaxhuese e grantit pranë Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është e detyruar të marrë në dorëzim dhe shqyrtim çdo aplikim të paraqitur, i cili plotëson kriteret e kësaj rregulloreje.
- Pas shkarkimit të dokumentacionit të aplikimit, njësia menaxhuese hap një dosje aplikimi për aplikuesin dhe bën regjistrimin e aplikimit i cili do të pajiset me një numër të dedikuar aplikimi.
- Pas mbylljes së thirrjes, aplikimi do të merret në dorëzim nga njësia menaxhuese e grantit, e cila duhet të analizojë aplikimin për t'u siguruar në lidhje me plotësimin siç duhet të kriterëve dhe dokumentacionit të kërkuar. Pas këtij shqyrtimi, Menaxheri i grantit informon dhe ia paraqet për vlerësim Komisionit të vlerësimit.
- Nëse aplikuesi has paqartësi dhe vështirësi gjatë procesit të aplikimit, ai do të ndihmohet dhe këshillohet nga njësia përgjegjëse pranë Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

VIII. SHPALLJA E PROJEKTEVE FITUESE

Jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të afatit të përcaktuar për dorëzimin e aplikimeve, Komisioni i vlerësimit mbledhet për të shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha aplikimet e mbërritura nga *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve.

Në rastet kur është e nevojshme, Komisioni ka të drejtë të kërkojë informacione ose dokumentacion shtesë nga aplikuesit. Informacioni ose dokumentacioni shtesë duhet të plotësohet nga aplikuesi brenda një periudhe kohore prej 3 ditësh nga momenti i njoftimit.

Në përfundim të procesit të shqyrtimit Komisioni plotëson raportin vlerësues për çdo aplikim duke marrë vendimin për secilin dhe përcakton nivelin e grantit për përfituesit *startup* ose lehtësues.

Miratimi i dhënies së grantit merret me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit nga ana e Ministrisë përgjegjëse për sipërmarrjen të vendimit të Komisionit të vlerësimit, bazuar në pikën 7 të nenit 14 të ligjit nr. 25 datë 31.03.2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve”.

Brenda një periudhe 3 ditë pune nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, aplikuesit njoftohen për rezultatet e aplikimit.

Aplikuesit fitues njoftohen individualisht për të firmosur Marrëveshjen e grantit nënshkruar midis fituesit dhe Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Aplikuesit jo fitues do të njoftohen nëpërmjet postës elektronike. Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, aplikuesit jofitues kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit pranë Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Njoftimi për aplikuesit fitues dhe jo fitues do të bëhet nëpërmjet e-mailit me adresë startup@sipermarrja.gov.al.

Projektet e shpallura fituese duhet të zbatohen në një afat maksimal 5 muor nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së fitimit të grantit midis përfituesit dhe Ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

IX. PROCEDURA E DISBURSIMIT TË GRANTIT

Disbursimi i grantit, për projektet e shpallura fituese, bëhet deri në 3 këste, sipas aktiviteteve dhe zërave të buxhetit të miratuar në kontratën midis palëve, kundrejt dorëzimit të faturës/ave të shpenzimeve të kryera dhe dokumentacionit të kërkuar sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.

Disbursimi i grantit do të bëhet kundrejt dorëzimit të dokumentave të mëposhtëm:

1. Faturat e shpenzimeve të kryera për secilën fazë disbursimi.
2. Transfertat bankare të cilat konfirmojnë kryerjen e pagesave, të firmosura dhe vulosura nga banka përkatëse, për secilën fazë disbursimi.
3. Raport përmbledhës në përfundim të projektit, për disbursimin e fazës së fundit. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë dëshminë e ndërmarrjes mbi hapat dhe aktivitetet e ndërmarra për zbatimin e projektit, përshkrimin e shpenzimeve të realizuara, si dhe impaktin e pritshëm pas zbatimit të projektit. Gjithashtu raporti duhet të përmbajë fotografi dëshmuese të shpenzimeve të kryera, aktiviteteve të realizuara sipas planit të aplikimit të miratuar.
4. Të dhënat bankare të aplikuesit përfitues, të konfirmuara nga banka përkatëse.

Dokumentacioni paraqitet në origjinal ose në kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin.

Këstet do të kalojnë në llogarinë e fituesit, brenda 15-ditëve pune nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar.

Në rast se lind nevoja për shpjegime apo dokumentacion shtesë, subjekti do të njoftohet për të kryer plotësimet përkatëse brenda 5-ditëve pune nga marrja e njoftimit.

Disbursimi për fituesit e kategorisë lehtësues si akademi, bashki dhe shkollat e mesme dhe profesionale do të bëhet parafinancim sipas fazave të rëna dakord në kontratë.

Kur të dhënat e paraqitura në raportin përmbledhës nuk plotësojnë kërkesat e grantit, raporti do t'i kthehet ndërmarrjes, i shoqëruar me komentet përkatëse dhe shpjegimet në lidhje me të dhënat ose detajimet shtesë që kërkohen.

Aplikuesit e shpallur fitues dhe që përfundojnë zbatimin e projektit dhe përfitojnë disbursimin e grantit, janë të detyruar të sigurojnë të dhëna në lidhje me rezultatet e asistencës së dhënë për një periudhë 5-vjeçare pas përfundimit të projektit.

X. PROCEDURA E MONITORIMIT TË PROJEKTEVE FITUESE

Monitorimi i projekteve fituese do të kryhet nga njësia menaxhuese pranë Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Monitorimi i projekteve fituese do të realizohet në fazat kryesore si:

- gjatë zbatimit të fazave të projektit;
- pas disbursimit total të grantit të përfituar;
- deri në 1 vit pas mbylljes së zbatimit të projektit fitues.

Njësia monitoruese kryen dhe plotëson raportin e monitorimit në bashkëpunim me aplikuesin përfitues, sipas fazave të mësipërme.

Raporti i monitorimit, pas plotësimit, nënshkruhet njëkohësisht nga njësia monitoruese dhe nga aplikuesi përfitues.

Formati i raportit monitorues, përgatitet nga njësia menaxhuese pranë Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

XI. KRITERET VLERËSUESE

Projekt aplikimet do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit nga ana e Komisionit të vlerësimit. Ky Komision do të vlerësojë aplikimet mbi bazën e pikëzimit të paracaktuar si më poshtë.

Për aplikuesit *startup*:

Kriteri vlerësues	Pikët
Përputhshmëria e modelit të biznesit me kriteret e thirrjes së grantit	15
Mungesa e burimeve ekonomike nga aplikuesi për t'u vetëfinancuar	10
Qartësia e përshkrimit të impaktit dhe rezultateve të matshme	15
Qartësia e përshkrimit të treguesve të inovacionit	20
Qartësia e përputhshmërisë së burimeve njerëzore me aktivitetet e parashikuara në aplikim	10

Aplikuesi është femër	10
Aplikuesi është deri në 30 vjeç	10
Aktivitetet e <i>startup</i> -it kanë impakt pozitiv mjedisor	10
Totali	100

Për aplikuesit lehtësues të *startup*-eve:

Kriteri vlerësues	Pikët
Përputhshmëria e projektit me kriteret e thirrjes së grantit	15
Qartësia e eksperiencës së aplikuesit në fushën e mbështetjes së <i>startup</i> -eve	10
Qartësia e përshkrimit në aplikim të impaktit dhe rezultateve të matshme	15
Qartësia e përshkrimit të treguesve të inovacionit	20
Qartësia e përputhshmërisë së burimeve njerëzore me aktivitetet e parashikuara në projekt	10
Cilësia dhe qartësia e përfshirjes së elementit ndërkombëtar në projekt	10
Qartësia e buxhetit të projektit	20
Totali	100

Fituesit do të shpallen sipas renditjes së pikëve të mbledhura, në raport me fondin total në dispozicion.

XII. PËRGJEGJËSITË E FITUESVE

- Respektojnë në mënyrë rigoroze dhe integrale të gjitha deklaratat e shprehura dhe angazhimet e përfshira në formularin e aplikimit.
- Vënë në dispozicion të Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes çdo informacion që lidhet me zbatimin e projektit;
- Paraqesin te Menaxheri i grantit një raport në lidhje me përfundimin e projektit, faturat origjinale për shpenzimet, si dhe çdo dokument të nevojshëm për të bërë të mundur kryerjen e pagesës;
- Pranojnë çdo lloj monitorimi, vlerësimi dhe/apo auditimi për të cilat projekti i aprovuar mund të bëhet objekt, duke siguruar të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, pasi të jenë njoftuar 48 orë para.
- Përfundojnë projektin brenda kohës së parashikuar në marrëveshje.

XIII. KONFIDENCIALITETI I TË DHËNAVE

Në bazë të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”, gjithë informacioni i dhënë nga aplikuesit për qëllim të përfitimit nga granti, veçanërisht e gjithë korrespondenca e shkëmbyer është konfidenciale dhe nuk do të zbulohet. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes do të ruajë në mënyrë konfidenciale informacionet e marra nga ndërmarrjet.

Asnjë e dhënë e marrë për Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes nga ana e aplikuesve nuk do t’u bëhet e ditur palëve të treta pa miratimin e tyre.

Megjithatë, informacioni në lidhje me zbatimin e grantit, në veçanti identifikimi i aplikuesve të mbështetur, të dhënat e përgjithshme rreth buxhetit, financimit, aktivitetet e kryera, rezultatet e arritura, ndikimet dhe të tjera të ngjashme, mund të përdoren, të publikohen ose shpërndahen nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes pa ndonjë kufizim.

Vetëm për raste të veçanta, të tilla si ngritja e ndërgjegjësimit, promovimi dhe shpërndarja, rastet studimore dhe të tilla të ngjashme, informacioni mund të zbulohet nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes me marrëveshje të veçantë me ndërmarrjet e përfshira të cilat, nga ana e tyre, angazhohen për të lehtësuar zbulimin e informacionit, në rastet kur nuk vihen në lojë interesat përkatëse tregtare dhe/ose sekretet e tyre.

XIV. NJËSIA MENAXHUESE E GRANTIT

Njësia menaxhuese për funksionimin e grantit pranë Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes përbëhet nga:

1. Menaxheri i grantit i cili përgjigjet për zbatimin dhe menaxhimin e grantit dhe kryen detyrat si më poshtë:
 - promovimin e grantit dhe ndërgjegjësimin e individëve dhe bizneseve për aplikim, së bashku me njësinë e shërbimit *startup-one-stop-shop*.
 - sigurimin e dokumentacionit të kërkuar nga Komisioni i vlerësimit si dhe shpërndarjen e tij pranë anëtarëve të paktën 2 ditë përpara mbledhjes të Komisionit.
 - pjesëmarrjen në mbledhjet e Komisionit të vlerësimit, pa të drejtë vote, referimin e projekteve aplikuese dhe mbajtjen e procesverbalit përkatës të mbledhjes, i cili i paraqitet për shqyrtim dhe nënshkrim Komisionit të vlerësimit;
 - marrjen në dorëzim të raporteve përfundimtare të paraqitura nga përfituesit e granteve, të analizuara dhe kontrolluara nga njësia e shërbimit *one-stop-shop* dhe kërkimin e informacioneve të tjera dhe/ose dokumentacionit shtesë sa herë që e gjykon të nevojshme;
 - kontrollin dhe aprovimin e të gjithë përgjigjeve zyrtare që do t'u dërgohen aplikuesve;
 - hartimin e raportit final të grantit në fund të vitit kalendarik dhe paraqitjen e tij pranë Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Raporti final i grantit duhet të përmbajë ecurinë e grantit gjatë gjithë vitit kalendarik, aplikuesit dhe fituesit, si dhe një analizë mbi problematikat e hasura dhe impaktin e grantit. Për hartimin e këtij raporti Menaxheri i Skemës ndihmohet nga njësia e shërbimit *startup-one-stop-shop*.

2. Njësia e shërbimit *startup-one-stop-shop* e cila përgjigjet për administrimin e grantit dhe ruajtjen e gjithë të dhënave të brendshme të saj dhe kryen detyrat si më poshtë:
 - promovimin e grantit, së bashku me Menaxherin, nëpërmjet aktiviteteve promovuese, publicitet, ndërlidhje me postë ose e-mail dhe promovim në të gjitha kanalet e komunikimit.
 - shkarkimin e dokumentacionit dhe mirëmbajtjen e gjithë aplikimeve;
 - dërgimin e përgjigjeve në lidhje me kërkesat për informacion shtesë brenda afateve kohore të përcaktuara dhe ndihmën për aplikuesit që kanë vështirësi në procedurën e aplikimit online;
 - kontrollimin e vlefshmërisë së aplikimeve së bashku me Menaxherin;
 - përgatitjen e gjithë dokumentacionit të kërkuar prej Menaxherit për Komisionin e vlerësimit;
 - mbajtjen e të dhënave në lidhje me zbatimin e grantit;
 - mbajtjen e të dhënave të plota në lidhje me progresin dhe arritjet e aplikuesve, të cilat kanë ardhur si rezultat i grantit të dhënë;
 - përgatitjen e draft raportit final të grantit së bashku me Menaxherin;
 - analizimin dhe kontrollin e raporteve përfundimtare të paraqitura nga përfituesit e granteve së bashku me Menaxherin;
 - mbajtjen e dosjeve të aplikuesve deri në momentin e dorëzimit të tyre pranë financës të njësisë paguese.